



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më ___/ ___/ 2021

VENDIM

Nr.27, date 23 /07/2021

PËR

PROJEKTIN E ZBATIMIT ME OBJEKT "REHABILITIM I DIGES SE SHQEFNIT"

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndertimin, Shfrytëzimin dhe Mirembajtjen e Digave dhe Dambave" si dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave", Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM), në mbledhjen e dates 23.07.2021 mori në shqyrtim Projektin e zbatimit për Rehabilitimin e Diges se Shqefnit.

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit teknik të paraqitur u konstatua se:

1- Tek **Studimi i përgjithshëm teknik** i projektit të zbatimit mungojne

a-**Verifikimi i qendrueshmerise se diges** (kerkese e pikes 1.1.9 nenit 9 te VKM 147). Ky verifikim i shoqeruar me llogaritjet perkatese te cilat mungojne duhet te behet per gjendjen aktuale dhe per rastin pas rehabilitimit te diges.

b- **Vellimi i ujit ne ujembledhes sipas matjeve faktike** (ne kete ujembledhes nuk eshte bere asnje matje e volumit te ujit qe prej 40 vitesh) dhe **kurbat e vellimit dhe te siperfaqes sipas matjeve faktike ku te jene niveli i vdekur**, niveli normal, niveli maksimal si dhe koha e zbrazjes se ujembldhesit

c- **Te dhena per hartimin e planit te alarmit** (kerkese e pikes 1.1.17 e nenit 9 te VKM Nr. 147) per perballimin e pasojave qe mund te vijne si rezultat i vales qe krijohet ne zonën poshte diges ne rastet kur shkarkohet plota maksimale, kur ka shkarkim i sforcuar dhe ne rastin e prishjes se diges. Per kete pike, duhet te jepen edhe llogaritjet e vales vershuese per rastet e mesiperme si dhe harten e permbytjes.

2- **Studimi sizmik** është mjaft i cekët dhe rezulton vetëm me nje harte sizmike te vjeter te pashoqeruar me analizen perkatese te rrezikut sizmik (nuk eshte perdorur hartat e vleresimit te rrezikut sizmik te miratuara nga IGJEUM dhe KKDM). Ne kete pjese mungon vleresimi i rrezikut sizmik te zones (i kerkuar tek pika 1.4.4 e nenit 9 te VKM Nr. 147)

3- **Studimi mbi instrumentat e kontrollit dhe matjeve** (e kerkuar tek pika 1.8 e nenit 9 te VKM Nr. 147) **mungon**. Projekti nuk ka parashikuar instalimin e asnje instrumenti per sistemet e kontrollit dhe monitorimit te kerkuara nga ICOLD dhe VKM perkatese

4- **Projekti I zbatimit i paraqitur prane KKDM per shqyrtim eshte hartuar ne vitin 2018** gje e cila tregon se pervec te tjerave, ky project nuk ka marre ne konsiderate perkeqesimin e situates ne trupin e diges ne tre vitet e fundit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

Bazuar në dokumentacionin teknik të paraqitur nga Bashkia Mat si shfrytëzues i kësaj dige, kushtet aktuale të diges, si dhe problematikave të mesiperm, KKDM,

VENDOSI:

- 1- Të Mos Miratojë Projektin e Zbatimit të paraqitur nga Bashkia Mat për "Rehabilitimin e Diges së Shqefnit" për arsye të mosplotësimit të kërkesave të VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave", Nenit 9,10 dhe 13
- 2- Ti kerkoj Bashkise Mat si shfrytëzues i digës dhe nënobjekteve të saj:
 - Rishikimin e Projektit të zbatimit për Rehabilitimin e kësaj dige në funksion të gjendjes aktuale të diges dhe të volumit aktual të ujit në rezervuarin e krijuar prej saj.
 - Kryerjen e Verifikimit të qendrueshmerise së diges në gjendjen aktuale dhe pas rehabilitimit të parashikuar
 - Kryerjen e studimit sizmik dhe studimit për instrumentat e kontrollit të diges sipas legjislacionit në fuqi dhe udhëzimeve të KKDM
 - Kryerjen e matjeve të volumit aktuale të ujit në rezervuarin e krijuar nga diga e Shqefnit dhe përgatitjen e kurbave të volumit dhe të sipërfaqes së ujit në rezervuar.
 - Plotesimin e dokumentacionit teknik të projektit sipas komenteve të KKDM të dhena me me sipër dhe legjislacionit në fuqi duke përfshirë studimet e mesipërme si dhe llogaritjen e vales shkatërruese të ujit si dhe hartat e permbytjeve në rast të ndonjë prishje të mundshme të diges
 - Shoqerimin e projektit të zbatimit me një raport të hartuar dhe të firmosur nga një studio këshillimi e licencuar me eksperience në fushën e projektimit ose nga një institucion shtetëror i caktuar me ligj për kryerjen e këtyre raporteve
 - Marrjen e masave për një monitorim të vazhdueshëm të gjendjes dhe sigurisë së diges si dhe hartimin e planit të gadishmerise në rastet e emergjencave civile të kërkuar nga legjislacioni në fuqi.

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për zbatimin e këtij Vendimi në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KRYETARI

Arjan JOVANI

